



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 285 Prot.

Tiranë, më datë 07.05.2025

VENDIM

Nr. 257, datë 07.05.2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 07.05.2025:

VENDOSI

1. Miratimin e projekt idesë (Dizajni skematik) “*Qendra e Vizitorëve në Butrint*”, Brenda Kufirit Park Arkeologjik, me aplikues Cultural Heritage Without Borders-Albania dhe zhvillues **Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, me rekomandimet;**
 - Struktura e propozuar për realizimin e “*Portës arkeologjike*” të detajohet nga ana strukturore; Projekti lidhur me strukturën e objektit të jetë i firmosur nga një inxhinier i licencuar i cili të depozitojë dhe deklaratën e përgjegjësisë profesionale;
 - Të arsyetohet qëllimi i ndërtimit të këtij teatri “amiteatër” sipas projekt-idesë;
 - Të detajohet në mënyrë të qartë mënyra e ndërtimit të urës së kalimit nga qendra e vizitorëve deri te liqeni;
 - Të detajohet grafikisht mënyra sesi do të realizohet elementi ndarës që pengon kalimin e njerëzve mbi strukturën e mbulimit të portës arkeologjike (sipas citimit në raportin e projekt-idesë);
 2. Projekt-ideja të përcillet për mendim në UNESCO;
 3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
 4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
 5. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Joli MITROJORGJI



KRYETAR

Blendi GONXHJA